



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

308

01-397

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizreni	03-12-2021

SENATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më 26.11.2021

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 42 të Statutit të Universitetit sipas Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013, si dhe në zbatim të Rregullores për procedurat e përzgjedhjes lidhur me emërim, riemërim dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, neni 10, paragrafi 3 dhe 4, Senati i Universitetit, sipas propozimit me nr. prot: 01-138 të datës 26.11.2021 të Këshillit të FShJM-së dhe propozimit me nr. Prot. 02- 413 të datës: 25.11.2021, në mbledhjen e mbajtur me datë: 26.11.2021 mori këtë:

V E N D I M

I. Anulohet nënpika 4 në pikën IV e konkursit për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, me nr. 01- 317, dt. 01.11.2021 në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe nënpika 1 në pikën II e konkursit në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Senati i Universitetit duke u bazuar në propozimin e Këshillit të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit të datës: 26.11.2021, me nr prot: 01-138 për anulimin e nënpikës 4 të pikës IV të konkursit për emërim, riemërim dhe avancim të personelit të rregullt akademik në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit të shpallur më datë: 01.11.2021 me nr prot: 01-317, dhe propozimit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike me nr. Prot. 02-413, të datës: 25.11.2021, për anulimin e nënpikës 1 në pikën II të konkursit për shkak të mungesës së aplikantëve në këtë pikë, në zbatim të dispozitave ligjore të Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes lidhur me emërim, riemërim dhe avancimin e Personelit Akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, neni 10, paragrafi 3 dhe 4, në mbledhjen e mbajtur me datë: 26.11.2021, vendosi për miratimin e propozimit për anulimin e pikave të lartcekura.

Prandaj mbi këtë bazë, Senati i Universitetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë brenda afatit prej 15 ditëve nga momenti i shpalljes në Ueb faqe të UUHP.

Vendimi t'i dërgohet:

Menaxhmentit;

Njesisë Akademike;

Zyrës së Personelit;

Uebfaqe të Universitetit dhe Arkiv.



Kryesues i Senatit

Prof. Asoc. Dr. Samedin Krabaj